

KËRKESË
Nr. 64, datë 11.1.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “GEZIM AGOLLI”

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Tiranë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitetet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: objekt i panjohur.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Tiranë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH TR-2019 003740-5, datë 5.10.2019, për subjektin “Gezim Agolli”, me adresë: Njësia Administrative nr. 5, rruga “P. Bogdani”, godinë 2-katëshe, nr. 36, Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Areti Beruka

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2019-003740-5

Datë 5.10.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-TR-2019-003740-2, datë 5.10.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Gezim Agolli”, NIPT: L41824007K, përfaqësuesi i autorizuar i subjektit nuk paraqiti dokument identifikimi, prej datës 5.10.2019 deri në datën 5.10.2019.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 5.10.2019 dhe e njoftoi në datën 5.10.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, i ndryshuar, neni 15/1, pika “d”, neni 15/2, neni 16, neni 15/1, pika “d”, neni 15/2, neni 16.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 9636, datë 6.11.2006, të ndryshuar, të nenit 20, pika 1/“ë/i”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 300 000 lekë

Gjobë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm . Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. --

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Brizita Gramo ID 0401030006

Vjola Ballici ID_0401030007

Personi i autorizuar i subjektit
Nuk paraqiti dokument identifikimi

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti "Gëzim Agolli" ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.